



2020 RAPORTI VJETOR



MESAZHI NGA DREJTORI EKZEKUTIV

Të dashur miq,

Kur e kam përfytyruar vitin e parë të Fellowshipit të Teach For Kosova, e kam imagjinuar organizimin e një Instituti Veror me studentë, dhe kam imagjinuar mësimdhënësit e Teach For Kosova të kenë një ndikim të menjëhershëm në klasa, duke filluar nga Shtatori. Përderisa ky vit, megjithëse ka qenë një sukses i konsiderueshëm, si shumë të tjerëve, dhe ne na është dashur të adaptoheshim.

Covid 19 ka ndryshuar mënyrën se si shumë nga ne jetojmë jetën tonë të përditshme, dhe na ka mësuar për humanizmin. Përkundër përpjekjeve tona të shumta, ne ishim kokëulur përballë faktit se sa pak kontroll kishim mbi tërë këtë situatë; shkollat u mbyllën papritur për dy javë, e më pas mbyllja vazhdoi për tërë vitin (shkollor). Këtë vit mësimi në shkolla dhe klasa është shkurtuar dhe ekziston frika se ky është një vit i humbur për shumë fëmijë – veçanërisht për ata në komunitetet tona më të cënueshme.

Në këtë kohë të vështirë, ne e dinim se nevoja për një lidhësi (udhëheqësi) në edukim ishte, ndoshta më e theksuar se kurrë më parë. Në vitin 2020, Teach For Kosova rekrutoi kohortën e saj të parë të fellows, mbajti të parin Institut Trajnues Veror, vendosi grupin e parë të mësimdhënësve në shkolla, dhe formalizoi bashkëpunimin tonë me organizatën globale Teach for All nëpërmjet një Memorandumi të Mirëkuptimit. 17 Fellows që rekrutuam, për të cilët mund të mësoni më tepër më poshtë, përfaqësojnë kohortën tonë inaugurose të liderëve të rinjë, të cilët janë të vendosur të jenë avokues për paanësi e drejtësi në sistemin arsimor. Ata janë një grup i shumëllojshëm i individëve liderë, të cilët janë të pasionuar për ndryshim shoqëror, për një sistem më të mirë arsimor, dhe për t'u siguruar që të gjithë fëmijët kanë qasje në mundësi të ndryshme.

Tash që Teach for Kosova sapo kompletoi vitin e parë të saj, ne jemi të përkushtuar për të vazhduar lëvizjen tonë për arsim cilësor. Në këtë vit që po vie, ne do të mbështesim fellows tanë aktual, deri sa ata po japin mësim për herë të parë; do zgjerojmë ndikimin tonë nëpërmjet projekteve të ndryshme me bazë në komunitet; dhe do të rekrutojmë 20 fellows të rinjë, të cilët do jenë kohorta jonë e dytë. Ne mezi presim të ndajmë me ju ndikimin që organizata jonë do të ketë në jetërat e nxënësve si dhe në komunitetet më të gjera ku ne shërbejmë.

Nëse ka një gjë që ky vit na ka mësuar, është se sa të lidhur dhe të varur jemi ndaj njëri-tjetrit. Ju faleminderit që jeni miq të Teach For Kosova dhe që na ndihmoni të zhvillohemi përgjatë rrugës. Ju faleminderit që besoni se së bashku ne mund të punojmë për t'u siguruar që nxënësit e Kosovës kanë qasje në arsim cilësor.

Me mirënjohje,
Egzon Gashi



BORDI I TEACH FOR KOSOVA



Athena Palmer



Dukagjin Pupovci



Vedat Gashi

“ Së bashku mund të bëjmë ndryshime ”



Armend Berisha



Fatmir Krasniqi

REFLEKTIM MBI VITIN E KALUAR

2020-ta na solli shumë sfida dhe pengesa me pandeminë COVID-19. Sidoqoftë, përmes punës së zellshme dhe dedikimit, ekipi i Teach for Kosova përmbushi objektivat vjetore.



Ngjarjet kryesore nga 2020-ta

- Zhvilluam hulumtim në nivel vendi, mbi situatën, problemet dhe mundësitë për përmirësim në sistemin arsimor;
- Rekrutuam kohortën e parë të Fellows;
- 17 Fellows – 70% gra/vajza; 25% nga komunitetet pakicë;
- Nënshkruam Memorandume të Mirëkuptimit me nëntë komuna (Drejtori Komunale të Arsimit) në Kosovë;
- Nënshkruam pesë Memorandume të Mirëkuptimit me Universitete Publike në Kosovë;
- Konferencë e organizuar me palë të interesit (përfaqësues komunash, shkollash, Ministrisë së Arsimit, sektorit të shoqërisë civile etj.);
- Implementuam Institutin e parë Veror (pesë javë trajnime intensive/25 ditë trajnime mbi leadershipin dhe mësimdhënien);
- Sesione trajnuese tematike mujore pas Institutit Veror;
- Rekrutuam katër mësimdhënës nga komunitetet Rom, Ashkali e Egjiptian;
- Vendosëm 8 mësimdhënës të rinjë udhëheqës nëpër shkolla publike (fillore e të mesme)
- Udhëhoqëm pesë fokus grupe dhe pesë sesione informuese me studentë nga pesë Universitete Publike të Kosovës
- Lansuam thirrjen për aplikime për kohortën e 2021 të programit të Fellowshipit

KONFERENÇA MBI EDUKIMIN NË KOSOVË



Me 27 shkurt 2020, Teach For Kosova ka organizuar Konferencën mbi Edukimin në Kosovë, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues nga drejtoritë komunale të arsimit nga mbi dhjetë komuna, nënkryetar e kryetar komunash, përfaqësues nga disa shkolla me të cilat kemi bashkëpunuar ngushtë, partnerë të ndryshëm vendor e ndërkombëtarë, si dhe anëtarë të bordit të organizatës sonë. Me prezencën dhe fjalën e rastit na ka nderuar zonja Deborah MacLean, zyrtare për marrëdhënie me publikun nga Ambasada Amerikane, profesor Dukagjin Pupovci nga Qendra për Arsim e Kosovës, si dhe kryetari i komunës së Kamenicës z. Qëndron Kastrati.


Teach For Kosova ka prezentuar programin e saj të rekrutimit, trajnimit dhe vendosjes në shkolla të mësimdhënësve të rinjë, si dhe ka kërkuar mbështjetjen e të gjithë akterëve në fushën e arsimit për të realizuar programin i cili synon të ngris cilësinë në arsim në Kosovë.




KOHORTA E PARË

Në vitin 2020, Teach For Kosova rekrutoi, trajnoi, dhe vendosi Kohortën e Parë të 17 liderëve të rinjë të jashtëzakonshëm. Ne vazhdojmë të rekrutojmë dhe të zgjerojmë forcën udhëheqëse kolektive e cila do të punojë të krijojë ndryshim sistematik.


Etniciteti



Fushat e Studimit



Rekrutimi 2019-2020



- 220 aplikime të pranuar
- 47 aplikantë të ftuar në 2 runde në Qendrën e Vlerësimit
- 17 të pranuar në program

7.7% të aplikantëve ishin pranuar

KOHORTA E PARË



BELKIZE ISLAMI-XHAFERI

Vendlindja: Gjilan, Kosova
Bachelor: Shkencat e aplikuara
Master: Automatizimi
i Proceseve Prodhuese

Jam Belkizja nga Gjilani 29 vjeçare.

Shkollën fillore dhe të mesme i kam përfunduar në Ferizaj, më pas vazhdova studimet bachelor po në këtë qytet ku edhe diplomova në vitin 2013 në Fakultetin e Shkencave të Aplikuar.

Qysh në moshë të re isha e angazhuar në aktivitete sociale dhe isha çdo herë e kyçur në mbrojtjen e të drejtave të pakicave pasi edhe unë vija nga një komunitet pakicë në Kosovë.

Gjatë kohës së studimeve isha pjesë e projekteve të ndryshme ku përmes angazhimit tim u bëra thirrje dhe ngrita zërin për shkollimin e vajzave nga komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian, si dhe për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave nga këto komunitete.

Vazhdova studimet master në drejtimin Automatizimi i proceseve prodhuese në Fakultetin Teknik, në Prishtinë dhe jam në prag të diplomimit. Vazhdoj të jem aktiviste e shoqërisë civile tanimë në një qytet tjetër të Kosovës, në Pejë.

Dëshira ime e madhe është të shoh sa më shumë vajza nga komunitetet që arrijnë shkollimin superior, më shumë gra të punësuar dhe shpresoj se një ditë do të jem motiv e model i një gruaje të fuqishme e rrethuar me vajza të reja që ndjekin ëndrrën e tyre.

Unë mendoj që duhet me i trajtu fëmijët në mënyrë të barabartë, dhe ndoshta me përdorë një qasje ndryshe të afrimitetit e jo duke i përçafu, por duke i dhënë fjalën të gjithëve, duke i marr mendimet e të gjithëve, duke i inkadruar në aktivitete, në lojëra, në detyra, domethënë me bo një gjithëpërfshirje në klasë që ata mos me u ndi më të padashur apo të lënë anash. Tek e fundit edhe pa i afër afër "fizikisht" ka shumë e shumë mënyra të tjera me i afër edhe me i dasht dhe të gjithë përkushtimin dhe dashnin me ua dediku atyre.

- Gentiana Gashi, Fellow



PETRIT MATOSHI

Vendlindja: Kamenica, Kosova
Bachelor: Etnologji dhe Antropologji Kulturore
Master: Trashëgimi Kulturore dhe Menaxhim i Turizmit

Jam Petriti nga Kamenica, 25 vjeç.

Shkollën fillore dhe të mesme i kam përfunduar në vendlindje. Kam studiuar në drejtimin Etnologji dhe Antropologji Kulturore në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", për të vazhduar me studimet master në drejtimin Trashëgimi Kulturore dhe Menaxhim i Turizmit në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti".

Prej vitit 2016 angazhohem nga Instituti Arkeologjik i Kosovës në fushata arkeologjike si: gërmime, konservime e restaurime në Kalanë e Kamenicës. Jam pjesë aktive e shoqërisë civile në Kamenicë, si bashkëpunor i disa OJQ-ve lokale, pjesë e Forumit për Trashëgimi Kulturore në Komunën e Kamenicës, pjesmarrës në disa aksione për largimin e mbeturinave në zona të ndryshme në komunën tonë si dhe organizator i disa aktiviteteve sportive.

Në mars të këtij viti jam njoftuar me Teach for Kosova dhe pa u menduar gjatë jam bindur se kjo është ajo që dua të bëj. Të jap mësim, duke ndjekur kështu hapat e babait dhe motrës sime. Lajmi për pranimin tim në këtë organizatë përveç se më ka gëzuar tejmasë, më ka ngarkuar edhe me përgjegjësi të madhe. Tani, mezi pres të vijë shtatori

Flas mire gjuhën angleze si dhe kam mësuar pak gjuhën serbe e arabe.

INSTITUTI VEROR 2020 NJË VËSHTRIM MË I AFËRT



- Trajnuam 17 Fellows të veçantë
- 150 orë trajnime, për pesë javë
- Në anketën tonë pas institutit, 100% të Fellows thanë se do ta rekomandonin fellowshipin te një mik apo një i afërm



- Gjithësej 12 mysafirë, folës, ishin të ftuar që të ndanin me stafin dhe Fellows e Teach For Kosovo dijen dhe përvojat e tyre profesionale.
- Ish-kryeministri Albin Kurti, Ushtruesja aktuale e Detyrës së Presidentit si dhe Kryetarja e Parlamentit znj. Vjosa Osmani, dhe Dekani i Fakulteti të Edukimit profesor Blerim Saqipi ishin tre ndër mysafirët tanë të shquar



SESIONET E TRAJNIMIT NJË VËSHTRIM MË I AFËRT



Instituti Veror

Nga 13 korriku deri më 14 gusht 2020, Teach For Kosova facilitoi Institutin e parë Veror me 17 Fellows. Secila ditë përmbante një ditë plot trajnime me sesione të facilituara, diskutime grupore, dhe një laramani aktivitete. Fellows-ve iu prezantuan koncepte të ndryshme të lidhura me mësimdhënien, lidhësin, posedimin e një mendësie të rritjes, ndërtimin e marrëdhënieve me palët e interesit në arsim, dhe shumë më tepër.

Veç kësaj, përgjatë javës së tretë dhe të katërt të Institutit, Fellows patën mundësinë të praktikojnë mësimdhënien, si në prani ashtu edhe atë virtuale. Secilit fellow i ishte rezervuar një klasë me nxënës (e përbërë nga fellows të tjerë) dhe me një anëtar të stafit të Teach For Kosova. Fellows ishin të monitoruar dhe pranonin feedback si nga “nxënësit” ashtu edhe nga monitoruesi nga stafi i Teach For Kosova

Trajnimet shtesë

Një përbërës i rëndësishëm i programit të Fellowshipit në Teach For Kosova është edhe trajnimi gjatë-shërbimit, i siguruar për të gjithë Fellows gjatë kohës së tyre si mësimdhënës.

Trajnimi gjatë-shërbimit përbëhet nga monitorimet mujore të Drejtorit tonë të Programit në klasët e Fellows, si dhe trajnimet tematike, mujore, bashkë me tërë grupin.

Në fund të 2020-ës, Fellows morrën pjesë në dy sesione trajnuese virtuale, të mbajtura në muajt Tetor dhe Nëntor

PARTNERËT STRATEGJIK



Teach For All

Teach For All i ka ofruar Teach For Kosovës mbështetje të vazhdueshme dhe udhëzim ndërsa organizata vazhdon të rritet dhe të zhvillohet. Puna jonë me Teach for All është formalizuar nëpërmjet një Memorandumi të Mirëkuptimit të nënshkruar në Nëntor të 2020-ës.

01



Mes Janarit 2019 dhe Gushtit 2020, Teach For Kosova implementoi projektin e parë, i cili u mbështet nga ATRC-USAID. Me këtë financim, Teach For Kosova pati mundësinë të realizoj vizita në Gjakovë, Mitrovicë, dhe Malishevë, ku ekipi ynë monitoroi klasë, organizoi fokus-grupe, dhe me të dhënat e mledhura, konceptoi një profil mësimdhënësi (model).

Si rezultat i partneritetit me ATCR-USAID, Teach For Kosova pati mundësinë të rekrutoj, trajnoj dhe të vendos Fellows-ët në komuna gjithandej vendit.



02

PARTNERËT STRATEGJIK



Innovation Centre Kosovo (ICK) ka mbështetur Teach For Kosova-n kur organizata nisi punën fillimisht në vitin 2018.

ICK e siguroi Teach For Kosova-n me një hapsirë pune tërësisht të sponzorizuar kur ekipi ynë kompletoi shumicën e punës së nevojshme për t'u lansuar si një organizatë e suksesshme.

03



Coca-Cola HBC ishte një nga sponzorët kryesorë të Institutit të parë Veror të Teach For Kosova. Coca-Cola mbështeti Institutin tonë me materiale, fonde, si dhe me pije për stafin dhe pjesëmarrësit.



The Kosovo Foundation for Open Society (KFOS) mbështeti parteritetin e Teach For Kosova-s me pesë Universitete Publike kudo nëpër Kosovë. Këto partneritete do të na mundësojnë të zgjerojmë rekrutimin tonë për Kohortat e ardhshme dhe do na mundësojnë të mbajmë sesione informative me këto Universitete

04

05



PARTNERËT STRATEGJIK

PARTNERITETET ME SEKTORIN PUBLIK

Komuna e Drenasit
Komuna e Fushë Kosovës
Komuna e Kamenicës
Komuna e Mitrovicës
Komuna e Prishtinës

Komuna e Ferizajit
Komuna e Gjakovës
Komuna e Malishevës
Komuna e Pejës
Komuna e Prizrenit

PARTNERITETET NË MES TË ORGANIZATAVE

Mentoring Our Future
Roma Versitas Kosovo

SBASHK

PARTNERITET ME UNIVERSITETE

University of Mitrovica "Isa Boletini"
Universiteti i Shkencave të Aplikuara
në Ferizaj

Haxhi Zeka University (Pejë)

STAFI JONË



Egzon Gashi
Drejtorekzekutiv



Anita Plakolli
Drejtoresh e Zhvillimit



Samir Shahini
Drejtore Programit



Dardan Hajrizi
*Menaxheri i Kontrollit
të Cilësisë*



Visar Kurti
*Zyrtari i Financave dhe
Administratës*

BASHKOHU NË BISEDË

@teachforkosova





LËVIZJE PËR ARSIM CILËSOR

Në një të ardhme, të gjithë fëmijët e Kosovës – pa marrë parasysh prejardhjen apo etninë – do të kenë qasje në një sistem arsimor që i përgatitë ata për një sukses të përjetshëm.

+383 49 170 597
www.teachforkosova.org

Prishtina
Rr. Sylejman Vokshi 13/5
Prishtina, Kosova, 10000